

VENDIM
Nr. 634, datë 27.10.2021

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS ‘KOLI MARKU’, PATOS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës ‘Koli Marku’, Patos”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Patos.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 3 593 865.59 (tre milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë pesëdhjetë e nëntë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 593 865.59 (tre milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë pesëdhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Patos.

5. Vlera për shpenzimet procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit në zyrat e Bashkisë Patos.

8. Bashkia Patos kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Patos.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Patos, fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe bëjnë regjistrimin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Patos.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Patos, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

TABELA E VLERËSIMIT PËR PASURITË PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS ‘KOLI MARKU’, PATOS”

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e përgj. e truallit m ²	Sip e prekur e truallit në m ²	Çmimi për truall (lek/m ²)	Vlera e truallit	Funksioni i godinës	Sip. e ndërtesës (m ²)	Sip. e prekur e ndërtesës (m ²)	Çmimi njësi/ m ² për banesat	Përqindja e amortizimit	Vlera e ndërtesës	Vlera e përgjith. (lek)	Gjendja juridike
1	Eduart Dervishi	2890	6/32-ND1	0	0	-	-	Shërbim	35	12.8	-	17.0%	324,530.86	324,530.86	Vërtetim hipotekor
2	Eduart Dervishi	2890	6/32-ND2	0	0	-	-	Shërbim	35	29.2	-	17.0%	740,335.94	740,335.94	Vërtetim hipotekor
3	Arjan Seitaj Resmije Seitaj	2890	6/50	41	20	2848	56960	Shërbim	38.8	20	-	19.0%	467,071.31	524,031.31	Vërtetim hipotekor
4	Altin Xhafaj	2890	6/49	26	4.1	2848	11676.8	Shërbim	26	4.1	-	19.0%	96,574.51	108,251.31	Vërtetim hipotekor
5	Arben Resulaj Alveritë Resulaj	2890	6/45	53.7	53.7	2848	152937.6	Shërbim	21.8	21.8	-	13.0%	511,330.58	664,268.18	Vërtetim hipotekor
6	Urani Likaj	2890	4/38+1-3	0	0	-	-	Banim	49	49	28000	0%	1,232,448.00	1,232,448.00	Certifikatë pronësie
													Totali	3,593,865.59	